



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 5/277
Datë: 14/12/2022

NJOFTIM

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 12.12.2022, mori vendim për publikimin e njoftimit për aplikim për lirim të studentëve të nivelit bachelor dhe master nga pagesa e semestrave për vitin akademik 2022/23, si në vijim:

Familjet që kanë më tepër se një student në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", do të paguajnë vetëm për njërin student, ndërsa për studentët tjerë nuk do të paguajnë. Lirohen vetëm studentët në nivel bachelor dhe master sipas kushteve të specifikuara në vijim:

Përfitimi nga lirimi i pagesës sipas prioriteteve:

Kur familja ka më shumë se një student në UP, lirimi nga pagesa për studentë do të bëhet sipas këtij prioriteti:

1. Studentët me statusin e studentit të rregullt në nivel bachelor (për semestrat e përsëritur)¹;
2. Studentët me statusin e studentit me korrespondencë në nivel bachelor (për semestrat e regjistruar për herë të parë dhe të përsëritur)²;
3. Studentët me statusin e studentit të rregullt në nivelin master (për semestrat e përsëritur)³.

Kufizimi i të drejtës së përfitimit nga lirimi i pagesës:

Njoftimi nuk aplikohet për studentët e nivelit bachelor dhe master, të cilët janë të liruar nga pagesa e tarifës së shkollimit sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 09/2021, studentët të cilët e realizojnë këtë të drejtë mbi një bazë tjetër të legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të UP-së, si dhe studentët e nivelit të doktoratës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a. Certifikata ose ekstrakti i lindjes për secilin prej studentëve të familjes së ngushtë;
- b. Certifikata e bashkësisë familjare;
- c. Kopja e letërnjoftimit të studentit/es;
- ç. Vërtetimi për statusin e studentit dhe dëshmia për regjistrimin e vitit akademik aktual (për secilin student veç e veç).
- d. Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje (pa i caktuar studentit prioritetet), numrin kontaktues dhe e-mail adresën e secilit student.

¹ Prioritet të parë për lirim do të kenë studentët e rregullt në nivelin bachelor në raport me studentin që ka status me korrespondencë në nivelin bachelor dhe me studentin e nivelit master.

² Prioritet të dytë për lirim do të kenë studentët që kanë statusin e studentit me korrespondencë në nivelin bachelor në raport me studentin e nivelit master.

³ Studenti i nivelit master mund të lirohet vetëm nëse nuk ka studentë që i takojnë dy prioriteteve paraprake.

Dokumentacioni i kompletuar për lirim nga pagesa në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje dorëzohen në zyrën e shërbimit të studentëve në ndërtesën e Bibliotekës Qendrore Universitare, ndërsa vendimi merret nga komisioni për lirim nga pagesa.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni për lirim.

Studentët të cilët lirohen nga pagesa do të informohen përmes njoftimit nga njësia akademike në të cilin kanë aplikuar dhe ueb faqes elektronike të UP-së: www.uni-pr.edu.

Afati i paraqitjes së dokumenteve është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të njoftimit, përkatësisht nga data 15.12.2022 deri me datë 29.12.2022, në ora 15:30.

Studentët përfitues të së drejtës për lirim nga pagesa duhet të parashtrojnë kërkesë pranë njësisë akademike përkatëse për rimbursim të mjeteve të paguara për regjistrim të semestrave përkatës të vitit akademik, duke bashkëlidhur dokumentet si në vijim:

1. Fletëpagesën e semestrit;
2. Kopjen e kartelës studentore ose të indeksit;
3. Kopjen e letërnjoftimit;
4. Kopjen e kartelës së bankës (numri i xhirollogarisë duhet të jetë i qartë).

Këshillë juridike: Studentët e pakënaqur me vendim të komisionit për lirim nga pagesa, mund të bëjnë ankesë pranë të njëjtit komision, në ndërtesën e rektoratit në afat prej 48 (dyzet e tetë) orësh pas publikimit të vendimit të komisionit për lirim nga pagesa.

